



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I47-2 Prot.
Nr. Dok. 202502869/

Tiranë 17/12/2025

Lënda: Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të azilkërkuesve në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit Babrru, Tiranë

Drejtuar: Sekretarit të Përgjithshëm
Ministria e Brendshme

TIRANË

Për dijeni: Z. Ermir ALIÇKA
Drejtor i Qendrës Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve, Babrru

TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falendëruar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar në përgjithësi angazhimin dhe punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, po ju njohim mbi gjetjet dhe rekomandimet monitorimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit Babrru, Tiranë më datë 04.06.2025 inspektimi në këtë institucion ishte i paparalajmëruar..

Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve. Inspektimi u krye sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi, dhe znj. Gloria Çarkaxhiu me detyrë nd/komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Objektivi i kësaj vizite ishte verifikimi i kushteve të jetesës së azilkërkuesve në Republikën e Shqipërisë, si dhe verifikimi i respektimit të të drejtave ligjore të shtetasve që trajtohen në këtë qendër, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme. Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Avokati i Popullit ka detyrimin ligjor t'ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime paraprake

Inspektimi u krye në përputhje me procedurën e monitorimit të Mekanizmit Kombëtar. Qendra e Azilkërkuesve, është një institucion në varësi të Ministrisë së Brendshme, që funksionon në bazë të ligjit nr. 10/2021, *“Për azilin në Republikën e Shqipërisë”* dhe në bazë të Vendimit nr. 332, datë 04.05.2016, të Këshillit të Ministrave *“Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit”*, me qëllim strehimin e të huajve, që kërkojnë azil në Republikën e Shqipërisë.

Qendra Kombëtare Pritëse është e vetmja në territorin e Republikës së Shqipërisë ku strehohen dhe trajtohen shtetas të huaj, që kërkojnë mbrojtje në Shqipëri. Në këtë qendër strehohen azilkërkuesit pas paraqitjes së kërkesës për azil, si dhe personat të cilëve iu është refuzuar aplikimi për azil, deri në përfundim të procedurave të ankimimit apo afatet për ushtrimin e tyre. QKPA-ja¹ ka buxhetin e vet, i cili është pjesë e buxhetit të Ministrisë së Brendshme, që mbulon çështjet e azilit dhe refugjatëve. Azilkërkuesit janë subjekte përfitimi të strehimit, ushqimit dhe të ndihmës financiare për nevoja emergjente vetjake, që ofron kjo Qendër, si dhe të ndihmave humanitare, të cilat jepen nga persona fizikë ose juridikë, shqiptarë ose të huaj. Mënyra dhe kriteret e përfitimit të strehimit, të ushqimit dhe të ndihmës financiare e humanitare si dhe masat e këtyre ndihmave, bazuar në pikën 6, Kreu I, dhe pikën 5, Kreu III të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 332, datë 04.05.2016, *“Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare Pritëse për azilkërkuesit, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm”*.

Pranimi i azilkërkuesve dhe personave të tjerë që gëzojnë mbrojtje në bazë të legjislacionit ndërkombëtar dhe kombëtar, bëhet me akt-pranimi (akt dorëzimi) të nënshkruar nga personi i autorizuar i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin ose Policisë së Shtetit dhe një prej specialistëve të Qendrës. Një kopje e akt-pranimit (akt dorëzimit) ruhet në zyrën e protokoll-arkivës. Pas pranimit të azilkërkuesit, sektori i mbështetjes së azilantëve në bashkëpunim me sektorin e financës dhe mbështetjes me shërbime, harton planin e masave për akomodimin

¹ Në zbatim të nenin 44, të ligjit nr.10/2021 *“Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të vendimit nr. 322, datë 4.5.2016 të Këshillit të Ministrave *“Për organizimin dhe funksionimin e qendrës kombëtare pritëse për azilkërkuesit”*

dhe përgatitjen e ambienteve, ku do të strehohen azilkërkuesit. Kjo Qendër ofron strehimin e azilkërkuesve, kujdesin për shërbimin shëndetësor, sigurinë e tyre, ushqimin, veshmbathjen dhe plotësimin e të gjithë nevojave jetike.

Azilkërkuesit pasi pranohen në qendër qëndrojnë mesatarisht nga 6 deri 12 muaj dhe më pas largohen me dëshirën e tyre, ditën kur nuk paraqiten në qendër stafi njofton komisariatën përkatës dhe drejtorinë e azilit.

Struktura e Qendrës Pritëse të Azilkërkuesve Babrru përbëhet nga 2 sektorë²:

-Sektori i mbështetjes së Azilantëve i cili përbëhet nga 3 punonjës ndër të cilët 1 psikolog, 1 punonjës social, 1 përkthyes.

-Sektori i Financës dhe shërbimeve mbështetëse i cili përbëhet nga 10 punonjës ndër të cilët 1 përgjegjës sektori, 1 specialist prokurimi, 1 specialist burime njerëzore, 1 protokollist, 3 kuzhinierë, 1 magazinier, 1 sanitare, 1 shofer.

Kapaciteti akomodues për azilkërkuesit në këtë qendër është për 220 persona, në ditën e inspektimit ishin të akomoduar 21 persona ndër të cilët 17 të rritur (8 gra dhe 9 burra), dhe 4 të mitur.

Në përputhje me procedurën e inspektimit, grupi i monitorimit u takua me drejtuesin e qendrës z. Ermir Aliçka, të cilit iu bë me dije qëllimi dhe metodologjia e inspektimit. Nga ana e stafit të institucionit u ofrua mundësia që grupi i inspektimit të kishte akses në përputhje me rregulloren dhe pa vështirësi në çdo ambient të qendrës. Gjatë takimit, grupi i punës kërkoi fillimisht informacion në lidhje me mënyrën e trajtimit të personave në qendër dhe respektimin e të drejtave të azilkërkuesve.

Nga informacioni i grumbulluar në vend, nga kontakti me stafin e institucionit si dhe nga këqyrja e dokumentacionit, e objekteve dhe mjediseve, rezultoi se rekomandimet e lëna nga Avokati i Popullit pas inspektimit të bërë në vitin 2024³, nuk kanë gjetur zbatim si më poshtë:

1. Nuk ishin marrë masat për rritjen e kuotës ditore të trajtimit me ushqim të azilkërkuesve, duke marrë parasysh rritjen e çmimeve të shportës së ushqimeve si dhe vlerësimin e tyre vit pas viti.

² Urdhri i Kryeministrit Nr.33 datë 13.02.2024 “Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Qendrës së pritjes për Azil”.

³ Rekomandim Nr.K4/I65-2,Prot.Dt.24.12.2024,“Rekomandohet përmirësimi i mëtejshëm i kushteve dhe i trajtimit të azilkërkuesve në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit Babrru, Tiranë”.

2. Nuk ishin marrë masat për rishikimin e organikës së kësaj Qendre duke pasur në vëmendje trendin e lëvizjeve migratore. Vlerësimin për shtimin e organikës me mjek, infermier, kujdestarë nate, punëtor mirëmbajtjeje dhe sanitare të cilët janë të domosdoshëm për plotësimin e nevojave të qendrës.

Ndërkohë kishin gjetur zbatim rekomandimet:

1. Ishin marrë masat për të vënë në dispozicion të personave dokumentacionit gjithëpërfshirës, për aksesin në të drejtat dhe rregullat e jetës në këtë Qendër në një gjuhë të kuptueshme për të gjithë, gjithashtu dhe të përmirësohet shpërndarja e informacionit për azilkërkuesit dhe grupet vulnerabël.
2. Ishin marrë masat e nevojshme për vendosjen në ambientet e qendrës të postereve, me të drejtat ligjore të shtetasve të huaj të akomoduar, në gjuhë të ndryshme.
3. Ishin marrë masat për pajisjen e dhomës së infermierisë me të gjithë titujt e medikamenteve të urgjencës në funksion të ruajtjes së shëndetit të personave të akomoduar në qendër.
4. Ishin marrë masat për etiketimin e kampionëve ushqimorë sipas përcaktimeve ligjore.
5. Ishin marrë masat për emërtimin e ambienteve të qendrës në gjuhën arabe dhe angleze për tu evidentuar nga të huajt qëllimi i tyre.

Në përgjigje të rekomandimit me nr. 38 Prot, dat.17.01.2025, Qendra e Pritjes për Azil na bën me dije se: Lidhur me zbatimin e Rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit i është dërguar shkresa me Nr. 59 Prot.,Tiranë më 30.01.2024” Kërkesë për zgjidhje” drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, ku është kërkuar ngritja e nivelit të kuotës ushqimore referuar nivelit të çmimeve të ngritura. Me shkresën Nr.63Prot., Tiranë, më 02/02/2024 “Relacion i detajuar për rritjen e vlerës së kuotës ushqimore”, është ngritur urdhri nga Ministria e Brendshme me Nr. 215, Prot, datë 01.11.2024 “ Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e nevojës për rritjen e kuotës ditore të trajtimit me ushqim të azilkërkuesve”.

Qendra i është drejtuar me shkresën nr.257 Prot., Tiranë datë 20.09.2024“ Propozim për ndryshimin e strukturës dhe organikës së Qendrës” drejtuar Sekretarit të përgjithshëm pranë Ministrisë së brendshme. Sa më sipër këto problematika ngelen ende të pazgjidhura dhe qendra ende nuk ka asnjë informacion zyrtar.

Organika dhe struktura aktuale sjell vështirësi në mbarëvajtjen e punëve, ndarjen e detyrave dhe funksionimin në tërësi. Përveç vështirësive në funksionimin e dy sektorëve, shqetësuese mbetet mungesa e pozicioneve për institucionin **si infermier, mirëmbajtës, mjek dhe kujdestar nate**.

Gjatë periudhës janar – maj 2025, ky institucion ka pritur 30 azilkërkues ndër të cilët:

-22 të rritur, ku nga këta 9 janë gra dhe 13 burra,

-8 të mitur, ku nga këta 3 janë vajza dhe 5 janë djem, të shoqëruar me familjet e tyre.

Familjet e akomoduar në qendër janë 6 me origjinë nga Kina, 17 nga Palestina, nga Siria, nga Afganistani dhe nga Irani.

Kuota ditore ushqimore⁴ ka mbetur e pandryshuar dhe vazhdon të jetë tejet e ulët dhe e pamjaftueshme duke mos iu përgjigjur nevojave të përshtatshme për ushqim. Duhet theksuar se në qendër vazhdimisht në periudha të ndryshme personat e akomoduar janë të mitur, nevoja për përkujdesje dhe ushqim është shumë e madhe. Ndonëse në vitin 2024 është ngritur grupi i punës për rivlerësimin e kuotës ushqimore, vërejmë me shqetësim se ende nuk ka një vendimmarrje lidhur me këtë çështje.

Përcaktimi i normativave të trajtimit me ushqim të azilkërkuesve është tepër i rëndësishëm pasi grup moshat e paraqitura në qendër janë të moshave të ndryshme, të cilët jo rrallëherë paraqiten në kushte jo të mira fizike.

Avokati i Popullit kërkon një rol më proaktiv nga Ministria e Brendshme lidhur me rritjen e kuotës ushqimore, e cila ende nuk ka marrë zgjidhje⁵.

Në institucion vazhdon të kishte mungesë **të mjekut të përgjithshëm**. Duke qenë se në QKPA akomodohen grup moshë (fëmijë të mitur e deri dhe në moshën e tretë), për shkak të origjinës nga vijnë, mbartin kultura të ndryshme, persona vulnerabël, që kanë probleme shëndetësore kronike e deri në më të rëndat, institucioni nuk mundet të ofrojë një shërbim të kualifikuar të ndihmës së parë.

Shtimi i personelit me një mjek të përgjithshëm është tejet i domosdoshëm, qoftë dhe si pozicion part - time.

⁴ Kuota ditore prej 330 lekë është përcaktuar me udhëzimin Nr.1547 datë 27.08.2009 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”

⁵ Rekomandime të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitet 2020-2024.

Infermieri në Qendër ofrohet nga RMSA-ja “Qendra e Shërbimeve Shqiptare për Refugjatë dhe Migrantë”. **Mungesa e një infermieri** të përhershëm në Qendër krijon probleme në emergjencat e krijuara dhe cenon ndjeshëm ofrimin e shërbimit ndaj personave të huaj të strehuar. Kjo problematikë është thelbësore përse në qendër akomodohet një numër i konsiderueshëm të miturish.

Në organikën e institucionit **mungon pozicioni kujdestar nate**, referuar faktit se kjo është një qendër e hapur, në të cilën shërbimet ofrohen 24/24 në orët e natës nevojitet për të qenë prezent në institucion.

Qendra ka vetëm 1 sanitare, fluksi i azilkërkuesve cili ndryshon çdo muaj dhe është i paparashikueshëm nevojitet shërbimi sanitar me dy turne.

Në institucion vazhdon **të mos të ketë mirëmbajtës**, mungesa ka krijuar probleme të vazhdueshme në institucion, për mirëmbajtjen e pajisjeve në lavanteri, dhomat e dusheve, në ambientet e përbashkëta (sallë interneti, bibliotekë, mensë dhe kuzhinë).

Institucioni i Avokatit të Popullit në vazhdimësi ju ka rekomanduar institucioneve, për marrjen e masave për shtimin e organikës me funksionet të përmendura më lart të cilat janë thelbësore lidhur me pritjen dhe trajtimin e azilkërkuesve si e vetmja qendër në Republikën e Shqipërisë që ofron ambiente akomoduese për kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare.

Trajtimi

Gjatë vizitës monitoruese, grupi inspektues mori kontakt me azilkërkuesit që gjendeshin në qendër dhe bisedoi me ta në mënyrë konfidenciale. Nga bisedat e kryera nuk rezultoi që ndaj tyre të ishte ushtruar dhunë fizike apo psikologjike nga personeli i Qendrës.

Sipas stafit të qendrës, pjesa më e madhe e personave të akomoduar zgjedhin ti thonë ankesat e tyre (që kryesisht lidhen me sasinë e pakët të ushqimit si rrjedhojë e kuotës 330 lekë) në mënyrë verbale, dhe jo duke përdorur kutinë e ankesave.

Gjatë kësaj periudhe në qendër nuk është paraqitur asnjë minoren i pashoqëruar nga familjarët.

Sipas ligjit Nr. 10/2021 "Për Azilit në Republikën e Shqipërisë" për rastet e fëmijëve të pashoqëruar të cilët shprehin qëllimin për mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, autoriteti për kufirin dhe migracionin njofton menjëherë strukturën e shërbimeve shoqërore në bashki dhe punonjësi për mbrojtjen e fëmijës

ndjek procedurën duke depozituar në gjykatë kërkesën për vlefshmërinë e masës së menjëhershme të mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative. Sipas ligjit vetëm kur kërkuesi i mitur ka mbushur moshën 16 vjeç mund të vendoset në qendra akomodimi për të rritur së bashku me kujdestarin e tij ligjor, dhe kur është në interesin e tij më të lartë.

Azilkërkuesit, të cilët dyshohet se mund të kenë qenë viktimë të torturës deri në momentin e mbërritjes në institucion apo akteve të tjera të rënda të dhunës, qoftë kjo seksuale, fizike apo psikologjike, i krijohen mundësitë për këshillim dhe/ose trajtim të veçantë mjekësor në spitalin e QSUT-së Tiranë 9në mungesë të mjekut në institucion) dhe psikologjik nga stafi social i qendrës.

Për çdo rast vlerësohet paraprakisht gjendja e tyre që në momentin e parë të mbërritjes nga punonjësit e Sektorit të Mbështetjes së Azilantëve, e më pas shihet mundësia që rasti të trajtohet brenda ambienteve të qendrës apo të referohet në instanca më të specializuara.

4 prej fëmijëve të akomoduar në qendër ishin regjistruar në shkollë, dhe një prej tyre në kopësht.

Nga inspektimi konstatuam se sistemi i ankesa/kërkesave ishte funksiononte konform akteve normative në fuqi, ishte vendosur një kuti e posaçme, e cila të mund të hapet në intervale të caktuara kohe nga punonjësit e institucionit të varësisë dhe punonjësit e qendrës. Në të gjitha rastet ankesat ose kërkesat më të shumta ishin verbale ose ankuesit bisedonin me punonjësin social.

Masat mbrojtëse

Personat e akomoduar në Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve që u intervistuan nga grupi i inspektimit, pohuan se mund të dilnin nga institucioni dhe se mund të zhvillonin aktivitetet e tyre personale pa probleme, duke gjetur mbështetje nga stafi i Qendrës.

Sa i përket çështjes së sigurisë, në godinën e re të Qendrës Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera në mjediset e përbashkëta, por jo në ato të banimit për të ruajtur privatësinë e tyre. Siguria e ambienteve të Qendrës bëhej nëpërmjet një kompanie të shërbimit privat të sigurisë fizike. Sistemi i kamerave monitorohej nga punonjësi i sigurisë.

Për shtetasit e huaj të pranuar, QKPA siguron shërbimet e mëposhtme sipas një plani të detajuar 1-mujor:

- Akomodim dhe strehim të përshtatshëm në varësi të gjendjes familjare të të huajit si dhe kushteve të strehimit
- Ushqim të gatuar dhe ambiente të përshtatshme e bashkëkohore në mensë të përbashkët.
- Materiale të ndryshme higjieno-sanitare për higjienë personale.
- Trajtim psikologjik nga specialistët e fushës.
- Trajtim shëndetësor në qendra shëndetësore shtetërore ose private (në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtare).
- Konsulencë juridike mbi legjislacionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar për personat që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare.
- Ofrohet biblioteka, salla e lojërave, shërbim interneti.
- Për fëmijët ekziston një ambient i veçantë i pajisur me biblioteke dhe lojëra të ndryshme sipas grup moshave.

Përgjatë inspektimit konstatuam se QKPA ka kapacitete infrastrukturore që të sigurojë shërbime dhe kujdesin e nevojshëm për azilkërkuesit dhe refugjatët e akomoduar. Megjithë planet e përcaktuara mujore, ngelet sfidë numri i pajmaftueshëm i burimeve njerëzore, si dhe kuota ditore ushqimore.

Kushtet materiale

Struktura e kësaj Qendre përbëhej nga **një godinë 4 (katër) katëshe dhe 5 (pesë) godina njëkatëshe**, godinat janë ndërtuar nga donatori UNHCR me fonde të BE-së, e cila kryen disa funksione: në katin e parë është kuzhina bashkë me ambientin e mensës dhe dy tualete, lavanderia, infermiera, dhoma e personave me aftësi të kufizuara, salla e kamerave të sigurisë.

Në godinën 4 katëshe, në katin e dytë janë vendosur salla e internetit, biblioteka, dhoma e fëmijëve për orët argëtuese dhe edukative, gjithashtu, po në këtë kat ndodhet edhe dhoma e akomodimit për azilkërkuesit, në katin e tretë dhe të katërt ato janë të pajisura me tualete për të gjitha ambientet, me sistem ngrohjeje dhe ftohjeje, ujë të ngrohtë 24 orë.

Godinat një katëshe janë 5 (pesë) nga të cilat 3 (tre) godina janë ambiente akomoduese me tualetet përkatëse, me sistem ngrohje dhe ftohje, me ujë të ngrohtë njëzet e katër orë, 1 (një sallë) pritjeje dhe intervistimi në momentin e mbërritjes të azilkërkuesve, 2 (dy) godina të tjera, janë zyra për administratën dhe ambiente ndihmëse për administrimin e Qendrës (magazina).

Kapaciteti akomodues sipas drejtuesit të qendrës është për 220 persona⁶, ndërkohë që përgjatë këqyrjes së dhomave të banimit konstatuam se ky kapacitet është i

⁶ Kapaciteti fillestar në qendër ka qënë për 150 persona.

dyfishuar për shkak të shtimit të numrit të krevateve 2 katësh në dhoma. Si psh: Dhoma banimi me madhësi 3x2m ishin të pajisura me 3 krevate 2 katëshe për akomodimin e 6 personave. Avokati i Popullit thekson se shtimi i numrit të shtretërve nuk mund të kthehet në shtim kapacitetesh e për rrjedhojë ngushtimin e hapësirave jetike për person.

Qendra menaxhohej me fondet e buxhetit të shtetit, ndërsa pajisjet dhe gjithçka tjetër mbi arredimin, ishin mbuluar nga donacionet e UNCHR-së. Nga këqyrja e ambienteve grupi inspektues konstatoi se në qendër ishte krijuar një kënd lojërash për fëmijët, gjithashtu edhe fusha sportive ishte ndërtuar rishtazi për kryerjen e aktiviteteve sportive të personave të akomoduar në qendër.

Lavanteria ishte në kushte shumë të mira e cila kishte 5 lavatriçe, si dhe pranë saj shërbente sanitarja e Qendrës.

Kuzhina ishte e pastër, kishte mjaftueshëm tavolina dhe karrige për azilkërkuesit. Punonjëset e saj ishin të pajisura me libreza dhe kushtet higjienike ishin të mira, menuja e përditshme ishte e afishuar. Kampionët e ushqimeve për të treja vaktet ruheshin në frigorifer, të etiketuar me datën përkatëse.

Për të rriturit ofroheshin 3 vakte në ditë, ndërsa për fëmijët 4 vakte. Sikurse u konstatua në vend nga grupi i inspektimit, edhe nga intervistat e bëra me azilantët e akomoduar në qendër, ushqimi ishte i një cilësie të mirë, por i pamjaftueshëm për shkak se nuk kishte shumëllojshmëri.

Në katet e sipërme të godinës së re, mjediset e banimit ishin të strukturuar në dhoma të mëdha, të pajisura me tualete dhe me dush brenda. Në ambientet e Qendrës kishte gjithashtu edhe Wi-Fi.

Dhomat e banuara kishin dritë natyrale dhe artificiale dhe ishin të pajisura me orënditë e nevojshme të reja. Sistemi i ngrohjes së ujit sanitar të Qendrës kryhej përmes paneleve diellore.

Në përgjithësi, në të gjitha intervistat e kryera, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishte mungesa në furnizimin e azilkërkuesve me shtroje, mjete të tjera të higjienës personale dhe asaj të përbashkët.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte pa kufizim orarësh dhe nuk u konstatuan probleme me energjinë elektrike. Për këtë të fundit kishte edhe një gjenerator në raste ndërprerje të energjisë.

Aktivitetet

Nisur nga fakti se Qendra është e hapur, personat e strehuar në të ishin të lirë të punonin, të dilnin nga Qendra, apo edhe të kryenin aktivitete të tjera personale. Grupi inspektues verifikoi se edhe përgjatë periudhës janar-maj nga verifikimi i dokumentacionit të hyrjeve dhe daljeve ata kanë qenë të lirë për të dalë jashtë Qendrës.

Qendra ka një bashkëpunim të ngushtë me organizatat: UNHCR, RMSA, ILO, Caritas Albania, Qendra tek Ura etj.

Me Qendrën tek Ura dhe RMSA në qendër është mundësuar realizimi i kursit të gjuhës shqipe për to një shërbim ky i cili ndihmon në integrimin e tyre në komunitet si dhe lehtësimin e komunikimit e socializimin e duhur.

Biblioteka funksiononte dhe kishte një numër të konsiderueshëm librash por konstatuam se të gjithë librat që gjendeshin në të ishin në gjuhën shqipe dhe jo të gjithë azilkërkuesit mund ti lexonin ato. Tërheqja dhe kthimi i librave bëhej duke shënuar të dhënat përkatëse në një kartelë personale.

Gjithashtu, kishte edhe një ambient të përbashkët për ndjekjen e programeve televizive.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit, grupi i inspektimit konstatoi se stafi i Qendrës mbante regjistrin elektronik themeltar për të gjithë personat e strehuar në qendër, si dhe regjistrin themeltar të sekretuar. Secili prej tyre kishte një dosje specifike me të gjithë dokumentacionin e duhur dhe zhvilloheshin takime të veçanta nga stafi psiko-social me ta.

Për regjistrimin e azilkërkuesve përdoren këto mënyra, data-basë e azilit, regjistri elektronik dhe regjistri i sekretuar. Regjistri i azilkërkuesve mban të dhënat demografike të azilkërkuesve të akomoduar. Sektori i mbështetjes së azilkërkuesve bën regjistrimin e azilkërkuesve nga regjistri në formë elektronike dhe regjistri i sekretuar. Sektori i mbështetjes së azilantëve bën përditësimin e të dhënave.

Në qendër ndodhet një dhomë e cila quhet “Dhoma e Fëmijëve” ku Punonjësit e Sektorit të Mbështetjes së Azilkërkuesve zhvillojnë lojëra argëtuese dhe zhvilluese për fëmijët.

Në ditën e inspektimit konstatuam se në ambientet e Qendrës ishin afishuar të drejtat dhe detyrimet e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në gjuhë arabe dhe angleze, si dhe afishimi i informacionit për mbrojtje ndërkombëtare. Gjithashtu, ishte kryer rishtazi dhe emërtimi i ambienteve të qendrës në gjuhën arabe dhe angleze për tu evidentuar nga të huajt qëllimi i tyre.

Shërbimi shëndetësor

Organika e Qendrës kishte mungesa në mjek të përgjithshëm dhe një kujdestar nate.

Në mjediset të Qendrës, ishte një dhomë e veçantë për mjekun me të gjitha pajisjet e duhura, si dhe ishte e pajisur me të gjithë titujt e medikamenteve të emergjencës.

Mungesa e mjekut në institucion qoftë dhe part time, ka krijuar një situatë jo të favorshme në ofrimin e kujdesit shëndetësor ndaj personave të huaj të cilët paraqiten në institucion. Këta persona jo rrallë herë paraqiten me nevoja të theksuara për kujdes shëndetësor, pasi ata vijnë nga një rrugëtim i gjatë dhe i mundimshëm. Nga biseda me stafin na u bë me dije se në rastet kur azilkërkuesit shfaqnin probleme shëndetësore, njoftohej Urgjenca Kombëtare, gjithashtu na u bë me dije se institucioni nuk ishte i pajisur me një autoambulancë.

UNHCR dhe RMSA kanë mundësuar mbështetjen për qendrën me një infermiere. Infermiera ka ofruar shërbimin e parë mjekësor si dhe ka asistuar në shoqërimin e tyre në qendra shëndetësore.

Gjithashtu librezat shëndetësore ishin të hapura për të gjithë azilkërkuesit e akomoduar në qendër, dhe skema e rimbursimit të ilaçeve ishte në funksion të plotë. Medikamentet mjekësore të rimbursueshme përfitoreshin me të njëjtën praktikë si shtetasit e tjerë të Republikës së Shqipërisë, në rastin konkret nga fondet e Qendrës. Ndërsa medikamentet mjekësore të parimbursueshme bliheshin sipas procedurave të prokurimit publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81 pika 2/b të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” ku parashikohet midis të tjerash se: “2. Në funksion të zbatimit të këtij ligji, mekanizmi kombëtar ushtron këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”.

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave nga Ministria e Brendshme për rritjen e kuotës ditore të trajtimit me ushqim të azilkërkuesve, duke marrë parasysh rritjen e çmimeve të shportës së ushqimeve si dhe vlerësimin e tyre vit pas viti.
2. Marrjen e masave nga Ministria e Brendshme për rishikimin e organikës së kësaj Qendre duke pasur në vëmendje trendin e lëvizjeve migratore. Vlerësimin për shtimin e organikës me mjek, infermier, kujdestarë nate, punëtor mirëmbajtjeje dhe sanitare të cilët janë të domosdoshëm për plotësimin e nevojave të qendrës.
3. Marrjen e masave për pasurimin e bibliotekës me tituj në gjuhën të huaja për të mundësuar aksesimin nga të gjithë shtetasit e huaj të akomoduar në qendër.
4. Marrjen e masave për ripërcaktimin e kapaciteteve akomoduese në qendër dhe uljen e numrit të shtretërve referuar hapësirave jetike për person.
5. Marrjen e masave nga stafi psiko-social për shtimin e aktiviteteve sociale dhe komunitare që ndihmojnë në integrimin e azilkërkuesve me vendin tonë pritës.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

**Mekanizmi Kombëtar për
Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër,
çnjerëzor ose poshtërues (MKPT)**

AHMET PRENÇI

d.v